



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:004470

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06345911

C-IV-14-6920

Ankuesi

S Đ, Beograd, Serbi.

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 18 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN124-1793, datë 02 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 01 nëntor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN124-1793, të datës 02 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim për paga të papaguara dhe 20 % në shumë prej 15,000.00 € për periudhë të pacaktuar kohore nga NSH “KHT Kosova” (në likuidim). Ankuesja pohon se kërkesa e saj është refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit për periudhën nga qershori 1999 deri më 24 nëntor 2005. Ankuesja më tej shton se e refuzon vendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe i propozon gjykatës që ta pranoj këtë ankesë, të anuloj vendimin në fjalë dhe të kthej lëndën në rishqyrtim te AKP. Ankuesja më tej thekson se ishte e punësuar në NSH nga data 12 janar 1991 deri në hyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë në qershor të vitit 1999 në pozitën sekretare teknike dhe do të kishte fituar të ardhura nga qershori 1999 deri më 24 nëntor 2005 si ditë e hapjes së procedurës së likuidimit të NSH-së në shumë totale neto prej 15,600.00 € (78 muaj x 200€). Ankuesja më tej shton se librezja e saj e punës është e hapur dhe se nuk ka krijuar marrëdhënie punë në ndonjë ndërmarrje tjetër dhe se është penguar të ushtroj të drejtën e

punës në NSH në periudhën e lartcekur në baza kombëtare andaj kërkon nga Agjencia t'i njoh dhe t'i paguaj: 1. Në emër të pagave të papaguara për periudhën prej 1 qershor 1999 – 24 nëntor 2005 në shumë totale prej 15,600.00 € si dhe kontributin për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor mbi të ardhurat neto prej 15,600.00 € në të njëjtën periudhë. Ankuesja më tej shton se ia lëmë gjykatës të vlerësoj nëse kërkesa në fjalë është e parashkuar, sipas mendimit të saj parashkrimi nuk mund të zbatohet për shkak të gjendjes së luftës që nga marsi 1999, mungesës së kushteve për qëndrim dhe lëvizje të sigurt të serbëve në Kosovë që zgjati deri më 24 nëntor 2005 dhe që është prezentë edhe tani për shkak të së cilës ajo është detyruar të shpërngulet nga Prishtina dhe Kosova. Ankuesja më tej pohon se të punësuarëve me kombësi shqiptare u është dhënë kjo e drejtë, atëherë trajtimi i ndryshëm i kësaj ankese do të kishte karakterin e diskriminimit në bazë të kombësisë. Ankuesja më tej shton se qëndrimi i tillë se nuk ka pasur parashkrim vlen edhe për pjesën e kërkesës që ka të bëjë me kërkesën për pagesën e kontributeve për sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor në të ardhurat neto prej 15,600.00 € sepse kjo kërkesë nuk parashkuar sipas rregullave materiale-juridike pozitive. Prandaj dhe për arsyet e cekura ankuesi i qëndron të gjitha pretendimeve dhe propozimeve të tij ankimore. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkëngjitur dëshmitë në kopje si: Librezën e punës nr. regjistri 7137, vendimin për caktimin e punëtorit në punë nr. 651, datë 1 shtator 1994 dhe vendimin për shfrytëzimin e pushimit vjetor nr. 253, datë 11 korrik 1997, që të dyja të lëshuara nga NSH.

Me 08 gusht 2024, AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj kundër ankesës, në të cilën thekson se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr. 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të nenit 74.2 të Ligjit nr. 06/L-086, ankesa në fjalë është e pavlefshme. E paditura më tej thekson se ankesa është e pabazuar. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në parashikon: *“se elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë; ...kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*. Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 parashikon që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkuar për tre vite”*. Për arsyet si më sipër, AL e refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme. Si përfundim, e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4. të Ligjit nr. 06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj, ka bashkëngjitur vendimin e kundërshtuar.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN124-1793, datë 02 tetor 2014, me të cilin vendim i ishte refuzuar si e pavlefshme / e parashkruar kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 15,000.00 € për një periudhën qershor 1999 – deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH “Sloga” – “KHT Kosova” (*në likuidim*).

Gjykata konstaton se, ankuesja në ankesën e saj kundër vendimit të kundërshtuar me të cilin i ishte refuzuar kërkesa e saj për paga të papaguara si e parashkruar vetëm i është referuar periudhës kohore prej 1 qershor 1999 – 24 nëntor 2005, përkatësisht deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së, përderisa bazuar në pretendimet e saj ankimore edhe vet ka deklaruar se për shkak të rrethanave të krijuara me hyrjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë përkatësisht mungesës së kushteve për qëndrim dhe lëvizje të sigurt si anëtare e komunitetit serb nuk ka mundur të paraqitet në vendin e saj të punës, pas muajit qershor të vitit 1999 për shkak të të cilave edhe është shpërngulur nga Prishtina dhe Kosova. Prandaj, ankuesja me asnjë dëshmi nuk mbështet pretendimet e saj për paga të papaguara për periudhën kohore objekt kontesti. Për më tepër, siç mund të konstatohet nga shkresat e lëndës, ankuesja nuk ka parashtruar prova relevante as në procedurën e likuidimit tek AL, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së saj në lidhje pagat e papaguara si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shumën e as lidhur me llogaritjen e pagave, e as për periudhën kohore për pagat e kërkuara përveç një shume të përgjithshme prej 15,000.00 €, të cilat pastaj me ankesën e saj i ka saktësuar si: në emër të pagave të papaguara për periudhën prej 1 qershor 1999 – 24 nëntor 2005 përkatësisht deri në fillimin e procedurës së

likuidimit të NSH-së në shumë totale prej 15,600.00 € si dhe kontributin për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor mbi të ardhurat neto prej 15,600.00 € në të njëjtën periudhë. Libreza e saj e punës si dhe vendimet e lëshuara nga NSH nga periudha e viteve të 90-ta nuk ofrojnë kurrfarë të dhëna në kuptim të bazës dhe lartësisë në lidhje me pretendimet e saj për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti dhe si të tilla nuk mbështesin ankesën e saj andaj ankesa refuzohet.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj për kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankueses në lidhje me kërkesën e saj për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti në kuptim të diskriminimit, por gjen se të njëjtat janë pretendime përgjithësuere dhe nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe, përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, në lidhje me kërkesën e saj për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti, prandaj si të tilla edhe refuzohen. Në kuptim të diskriminimit të pohuar nga ankuesja, për sa i përket pretendimit se është diskriminuar për shkak të kombësisë së saj serbe, gjykata vlerëson se ky pretendim është plotësisht i pabazuar, për arsye se refuzimi / parashkrimi i kërkesës për kompensim të pagave të papaguara në përputhje me nenin 608 të LPB (GZ 53/1976) është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë ndaj të gjitha kërkesave të parashtruara nga ana e punëtorëve të NSH-së tek cilido AL, pa marr parasysh përkatësinë etnike, moshën apo gjininë. Zbatimi i afateve të parashkrimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit është një kusht të cilin AL duhet të përmbush sipas ligjit, përkatësisht nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe kjo dispozitë nuk lë vend për interpretim, pa marr parasysh përkatësinë etnike ose kombëtare të parashtruesit të kërkesës.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Meqenëse ankuesja jeton si person i zhvendosur gjykata ka vendosur që ta liroj nga pagesa andaj si rrjedhojë e njëjta nuk do të ngarkohet me taksë gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar